



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri
Navale”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Ismail Qemali”,
Vlorë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. PhD Genta Rexha
2. Dr. Fatmir Basholli

Maj/2021



Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM PËR PROGRAMIN E
STUDIMIT BSC. NË "INXHINIERI NAVALE"**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor "Inxhinieri Navale"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 832, dt. 04.06.2008
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR Nr. 439, datë 09.09.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë i studimeve
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	20 PAE/1 PAK (v.a. 2019 – 2020)
18	Numri i studentëve:	31 (v.a. 2019 – 2020)
19	Komente / të tjera:	

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM



Programi i studimit *Bachelor* në “Inxhinieri Navale” është hapur me VKM Nr. 832, datë 04.06.2008 si Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) në “Inxhinieri Navale” dhe ofrohet nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare pranë Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë. Ky program studim nuk ka kaluar më parë në proces akreditimi.

Programi i studimit *Bachelor* në “Inxhinieri Navale”, është program studimi i ciklit të parë, me formë studimi me kohë të plotë, zhvillohet në gjuhën shqipe dhe i përket nivelit të 6^{të} të kualifikimit sipas kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kohëzgjatja normale e programit të studimit është 3 vite, gjithsej 180 kredite.

Kurrikula e këtij program studimi ka pësuar ndryshime nën masën 20%, miratuar me VS Nr. 70, dt. 31.10.2018 dhe i është përcjellë për informacion Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ndryshimet janë zbatuar duke filluar nga v.a. 2018 – 2019.

Programi i studimit *Bachelor* në “Inxhinieri Navale” synon të ruajë traditën kombëtare në ndërtimin dhe shfrytëzimin e anijeve, konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të kësaj tradite, në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit të sektorit detar dhe në harmoni me kërkesat e Organizatës Ndërkombëtare të Detarisë (*International Marine Organization – IMO*).

Programi i studimit *Bachelor* në “Inxhinieri Navale” synon të formojë specialistë të lartë në inxhinierinë detare, duke mbështetur zhvillimet kombëtare në fushën e detarisë dhe transportit detar.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) është ngritur nga ASCAL mbështetur në kërkesën e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, regjistruar në protokollin e ASCAL me Nr. 157 Prot., dt. 20.05.2019, "Për akredimin e parë të programeve të studimit të ciklit të parë Bachelor". GVJ përbëhet nga dy anëtarë: PhD. Genta Rexha dhe Dr. Fatmir Basholli. Koordinator teknik për ASCAL në këtë procedurë vlerësimi është MSc. Muhamed Prezja.

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë përzgjedhur duke patur në konsideratë kompetencat profesionale në lidhje me fushën inxhinierike të këtij programi studimi, eksperiencia e tyre në vlerësime të programeve të studimit, integriteti profesional, mungesa e konfliktit të interesit për të siguruar paanshmëri dhe objektivitet në gjykim dhe në vlerësim.

GVJ, në punën e tij, ka shfrytëzuar "Raportin e vlerësimit të brendshëm" të hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB), i ngritur pranë Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare pranë Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, si dhe dokumentacionin në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV) që shoqëronte këtë raport. Të dhënat e vëna në dispozicion përmes DVV u diskutuan dhe u verifikuan gjatë takimeve vlerësuese të zhvilluara online në datat 25 – 26 Shkurt 2021, në kujdesin e koordinatorit teknik të ASCAL. Institucioni kishte marrë të gjitha masat për realizimin me sukses të takimeve, në përputhje me agjendën e vizitës.

Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm u bë për shkak të kushteve të jashtëzakonshme të krijuara nga pandemia Covid – 19.

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur gjatë takimeve *online* me përfaqësuesit e Institucionit.



Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi u njoh me komentet e IAL mbi Draft-Raportit, shprehet si vijon:

Lidhur me komentin për Fushën 1, Standardi I.3, Kriteri 3/Fushën 2, Standardi II.3, Kriteri 2, Kriteri 4, Standardi III.2, Kriteri 1, Standardi III.5, Kriteri 1 – 2, Standardi III.7, Kriteri 1

GVJ nuk e pranon komentin mbi këtë pikë, pasi kurrikula e programit të studimit nuk ka kredite të dedikuara për detyrat e kursit (të konvertuara në orë mësimore sipas udhëzimeve përkatëse 1 – 2 orë/ECTS), të cilat shprehin edhe ngarkesën në auditor të studentëve për këtë veprimtari, pavarësisht se pedagogët e lëndëve mund ta përdorin aktualisht si formë për vlerësimin e njohurive.

Laboratorët janë një veprimtari shumë e rëndësishme për formimin praktik të studentëve dhe përfshirja e tyre brenda lëndëve të profilit inxhinierik, dhe jo vetëm brenda lëndës "Praktikë profesionale", i aftëson ata në profesion. Më poshtë disa lëndë ku veprimtaria labororë ka rëndësi në formimin e studentit, në përputhje me objektivat e saj, ku realizimi në mungesë të laboratorëve eksperimentalë, mund të realizohet përmes simulimeve në kompjuter (*software* në versionet student janë lehtësisht të aksesueshme në rrjet):

- Vizatim inxhinierik + CAD (praktikimi i CAD në kompjuter përmes software Autocad, Catia etj.),



- Mekanikë fluidesh (modelimi dhe simulimi i fluideve përmes modeleve në Fluent apo *software* të tjerë specifikë në inxhinierinë navale),
- Sistemet elektrike të anijes (modelimi dhe simulimi i sistemeve në Multisim, Pspice apo *software* të tjerë specifikë në inxhinierinë navale),
- Konstruksione navale (modelimi dhe llogaritja e strukturave në Ansys apo *software* të tjerë specifikë në inxhinierinë navale),
- Motorat diesel detarë (modelimi dhe simulimi i motorave diesel në GT-Power, Chemkin apo *software* të tjerë specifikë në inxhinierinë navale),
- Bazat e aplikimeve CFD (nga anglishtja *computational fluid dynamics* - llogaritje të dinamikës së fluideve, kërkon aplikimin e tyre konkret përmes *software* CFD),
- Etj.

Përsa i përket komentit të fundit, lidhur me vlerësimin e studentëve në provimin final me 60 pikë, GVJ mbetet i mendimit që ky provim duhet të jetë përcaktues për kalimin ose jo me sukses të lëndës nga ana e studentit, duke nxitur tek ai studimin e vazhduar deri në përmbylljen me sukses të lëndës.

Lidhur me komentin për Fushën 1, Standardi I.4, Kriteri 1, Fushë 2, Standardi II.5, Kriteri 1, 2, 3

GVJ nuk e pranon komentin mbi këtë pikë, pavarësisht se DITD ka përvojën më të gjatë në vend në drejtim të formimit të profilit të inxhinierit naval, ky department nuk plotëson të gjitha nevojat akademike për lektor me grada dhe tituj shkencor për të gjitha lëndët që ofron [Evidencë I] (p.sh. MSc. Miranda Vidhaj është lektore për disa lëndë “Teknologjia e ndërtimit të anijes”, “Sistemet energjitike të anijes” etj., Ing. Astrit Halili është lektor për lëndën “Motorët diesel detarë”, “Impiantet e lëvizjes së anijes”). Në këtë kuadër rekomandimi mbetet, që të paktën për lëndët për të cilat Institucioni nuk ka staf akademik me tituj dhe grada, të rekrutojë në kuadër të leksioneve, staf të jashtëm për të plotësuar këto nevoja, brenda 30% të ngarkesës së lejuar për angazhimin e stafit të jashtëm me kontratë. Gjithashtu, përfshirja e stafit akademik të jashtëm do të forcojë bashkëpunimet me Institucione të tjera të arsimit të lartë apo kompani, të cilat zhvillojnë aktivitetet e tyre në fushën e inxhinierisë navale, duke e hapur Institucionin drejt eksperiencave të reja dhe mundësive të tjera bashkëpunimi në kuadër të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Lidhur me komentin për Fushën 2, Standardi II.1, Kriteri 5 – 6

GVJ nuk e pranon komentin mbi këtë pikë. GVJ rekomandon Institucionin të rishikojë kurrikulën e programit të studimit duke saktësuar ngarkesën në auditor për secilën veprimtari: leksion, seminar, ushtrime, detyra/projekte, praktika, brenda secilës lëndë, në ECTS dhe në orë mësimore (duke qenë se VKM 41, datë 24.01.2018, nuk ka specifikime mbi raportet orë në auditor për ECTS, i referohemi tabelës 5, në udhëzimin 15, dt. 04.04.2008).



Lidhur me komentin për Fushën 2, Standardi II.4

GVJ nuk e pranon komentin mbi këtë pikë. GVJ në kriteret 1 – 5 shprehet: “Në vijim të standardit II.1, kriteri 5 dhe 6, në të cilat GVJ ka lënë edhe rekomandimet e tij, në tërësi, GVJ konstaton se organizimi i lëndëve/moduleve brenda kurrikulës është në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke mundësuar marrjen e njohurive dhe aftësive të nevojshme për krijimin e profilit të inxhinierit naval të aftë për tregun e punës”. Nisur nga sa më sipër, rekomandimet janë të njëjta si në standardin II.1, kriteri 5 dhe 6, por nuk janë përsëritur në këtë standard.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Navale”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE



Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” ofrohet në përputhje me prioritetet e zhvillimit kombëtar dhe rajonal [Evidencë A, Neni 3, pika 2].			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” synon të ruajë traditën kombëtare në ndërtimin dhe shfrytëzimin e anijeve, konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të kësaj tradite, në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit të sektorit detar dhe në harmoni me kërkesat e Organizatës Ndërkombëtare të Detarisë (<i>International Marine Organization – IMO</i>).			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Institucioni në përputhje me objektivat e tij të politikës arsimore, të kërkimit shkencor, të mësimdhënies dhe në respektim të lirisë së secilit, harton programe dhe projekte specifike sipas nevojave të fushave të ndryshme [Evidencë A, Neni 6, pika 3]. Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” është një nga programet e para të hapura pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, zhvillimi i mëtejshëm i së cilës ka patur rëndësi të veçantë krahas programeve të tjera të ofruara nga Institucioni.			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” synon të formojë specialistë të lartë në inxhinierinë detare, duke mbështetur zhvillimet kombëtare në fushën e detarisë dhe transportit detar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plot përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (DITD) pranë Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore (FSHTN) dhe është në përputhje me strategjinë e Institucionit dhe të Departamentit [Evidencë B, fq. 24, Evidencë I.2, fq. 4].
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë ka si mision ofrimin e programeve të studimit në fusha të ndryshme në të tre ciklet e studimit [Evidencë A, Neni 3, pika 1], me kurrikula, të cilat bazohen në shkencat dhe artet e lira, duke mundësuar aftësimin e studentëve në mjeshtëritë, njohuritë

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	dhe aftësitë e duhura për t'u bërë pjesë e tregut të punës [Evidencë C, Neni 4].								
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Emërtimi, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit <i>Bachelor</i> në "Inxhinieri Navale" janë në përputhje të plotë me fushat e studimit që DITD mbulon.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në "Inxhinieri Navale" synon që të formojë studentët për një karrierë të suksesshme inxhinierike në industrinë e shfrytëzimit dhe ndërtimit të anijeve, duke u dhënë studentëve njohuri dhe kompetenca profesionale të qëndrueshme në disiplinat kryesore si më poshtë [Evidencë I.3, Neni 4]: <ul style="list-style-type: none"> - arkitekturë navale, - konstruksione navale, - projektimi i anijes, - shfrytëzimi i anijes. Ky program studimi e aftëson studentin për të vazhduar studimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe është konform standardeve të parashikuara nga IMO model Course 7.04 dhe 7.02.
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Bazuar në DVV dhe në takimet <i>online</i> me përfaqësues të Institucionit, GVJ konstaton se nuk ka studime të mirëfillta të tregut të punës lokal dhe ndërkombëtar për programin e studimit <i>Bachelor</i> në "Inxhinieri Navale". Nga të dhënat e punësimit të vëna në dispozicion në vazhdim të takimeve <i>online</i> në Institucion [Evidencë 3 - 4 - 5], tabela 23, GVJ konstaton që nga 45 të diplomuar në total në vitet akademike 2016 - 2017, 2017 - 2018, 2018 - 2019, 8 (17.8%) punojnë në përputhje me diplomën dhe 14 (31.1%) jo në përputhje me diplomën. <p>GVJ rekomandon zhvillimin periodik të studimit të tregut të punës në bashkëpunim me aktorët lokalë dhe ndërkombëtarë, duke përcaktuar qartë kërkesat dhe nevojat e tyre, si dhe mundësitë e punësimit të studentëve.</p> <p>Gjithashtu, GVJ rekomandon Institucionin të forcojë lidhjen me alumnit duke mundësuar gjurmimin e punësimit të tyre të paktën për të diplomuarit në 3 vitet e fundit.</p>
Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë	Syllabuset e lëndëve të vëna në dispozicion, të azhornuara në vazhdim të takimeve <i>online</i> në Institucion [Evidencë 1], përcaktojnë objektivat formues, strukturën, përmbajtjen e lëndëve, rezultatet e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>prishme të të nxënit, të cilat synojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave me qëllim përgjigjen nevojave të tregut të punës.</p> <p><i>GVJ rekomandon rishikimin e shpërndarjes së krediteve brenda lëndëve, duke përfshirë në kurrikul edhe veprimtaritë laborator dhe detyra kursi.</i></p> <p><i>Gjithashtu, GVJ rekomandon që vlerësimi i provimit përfundimtar të jetë të paktën 60% e vlerësimit total, duke u bërë kështu përcaktues për kalimin ose jo me sukses të lëndës nga ana e studentit (me pikëzimin aktual të disa lëndëve, studentit mund të rezultojë kalues edhe vetëm me pikët e mbledhura gjatë vitit).</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="646 560 845 638">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="845 560 1053 638">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1053 560 1260 638">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1260 560 1418 638">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="646 638 845 696"></td> <td data-bbox="845 638 1053 696"></td> <td data-bbox="1053 638 1260 696" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1260 638 1418 696"></td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<p>Standardi I.4</p>	
<p>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Gjatë v.a. 2019 – 2020, në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” janë të angazhuar në mësimdhënie 20 PAE (2 Prof. Asoc. Dr., 6 Dr., 6 Dr. Proc. dhe 6 MSc.) dhe 1 PAK (1 MSc.) [RVB, tabela 6.4]. Stafit akademik i angazhuar ka kualifikimet dhe përvojën, në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të programit të studimit dhe lëndëve specifike që ata mbulojnë [Evidencë 1.9].</p> <p><i>GVJ rekomandon përfshirjen në mësimdhënie brenda 30% të ngarkesës së lejuar të stafit akademik me kontratë, duke mundësuar, përmes tyre, sjelljen e eksperiencave të tjera jashtë Institucionit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e studimit të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi [Evidencë 1.4, Neni 3].</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e studimit të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi [Evidencë 1.5, Neni 2].</p>






Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	DITD bashkëpunon me njësitë bazë brenda Fakultetit, por gjithashtu edhe me njësi bazë në Fakultetet e tjera në kuadër të shkëmbimit të stafit akademik [RVB, tabela 6.4]. Në funksion të mbarëvajtjes së programeve të studimit të gjitha strukturat akademike dhe administrative [Evidencë A, Kreu II] janë në bashkëpunim të vazhdueshëm. Detyrat e secilës njësi përcaktohen në rregulloren e Institucionit [Evidencë C] dhe në rregulloret e tyre përkatëse. Secila njësi raporton periodikisht në instancat nga të cilat varet.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	DITD në mbështetje të objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve bashkëpunon me aktorët e biznesit vendas [Evidencë I.15]. Falë këtyre bashkëpunimeve, Departamenti mundëson realizimin me sukses të praktikave profesionale pranë kompanive, të cilat operojnë në fushën e ndërtimit dhe riparimit të anijeve, ndërmarrjeve të industrisë navale, autoriteteve portuale, shoqërive të shfrytëzimit dhe menaxhimit të anijeve [RVB, fq. 12]. Në bashkëpunimet brenda vendit, vend të rëndësishëm zë edhe bashkëpunimi me Universitetin Politeknik të Tiranës, duke qenë ky dhe i vetmi Universitet në vend tërësisht inxhinierik. DITD në kuadër të projekteve ndërkombëtare bashkëpunon me Institucione të huaja [Evidencë I.2, fq. 8] duke mundësuar shkëmbimin e eksperiencave më të mira bashkëkohore.
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Në kuadër të analizës vjetore [Evidencë I.7], e cila diskutohet edhe në mbledhjet e departamentit, DITD analizon edhe bashkëpunimet e ndryshme me partnerë ndërkombëtarë. Nisur nga analiza vjetore e DITD, si dhe nga takimet online në Institucion me stafin akademik dhe drejtuesen e Departamentit, GVJ konstatoi se DITD ka qenë pjesë e projektit Tempus “Modernizing and harmonizing maritime education in Montenegro and Albania” për përmirësimin e kurrikulave të programeve të studimit dhe për të siguruar burime njerëzore të kualifikuara në sektorin detar përmes modernizimit të Arsimit të Lartë Detar. <i>GVJ rekomandon hartimin periodik të një raporti analitik për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të praktikave profesionale të studentëve.</i>
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	DITD në fillim të vitit akademik ngre komisionin për studimin për realizimin e praktikave mësimore [Evidencë I.16], i cili evidenton dhe vendos kontaktet me kompani të mundshme, pranë të cilave, studentët mund të zhvillojnë praktikat profesionale. Marrëdhënia midis kompanive dhe Institucionit formalizohen përmes marrëveshjeve zyrtare. Udhëheqësi i caktuar nga Departamenti koordinon punën me studentët.



Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	DITD në kuadër të projektit Tempus MARED ka ofruar kurse të studimit të vazhduar për detarët sipas STCW-2010 IMO [Evidencë I.12 – 1].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite [Evidencë 3 – 4 – 5, tabela 10, Evidencë I.3, Neni 6, pika 1]. Krediti i formimit i referohet kreditit të formimit sipas Sistemit European të transferimit të krediteve (ECTS) dhe shpreh volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore [Evidencë I.3, Neni 20].
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” synon që të formojë studentët për një karrierë të suksesshme inxhinierike në industrinë e shfrytëzimit dhe ndërtimit të anijeve, duke u dhënë studentëve njohuri dhe kompetenca profesionale të qëndrueshme në disiplinat kryesore si më poshtë [Evidencë I.3, Neni 4]:
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	<ul style="list-style-type: none"> - arkitekturë navale, - konstruksione navale, - projektimi i anijes, - shfrytëzimi i anijes.
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Ky program studimi e aftëson studentin për të vazhduar studimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe është konform standardeve të parashikuara nga IMO model Course 7.04 dhe 7.02. Nga takimet <i>online</i> me stafin akademik dhe studentë të këtij programi studimi, GVJ konkludon se njohuritë e marra e aftësojnë studentin për t’u integruar në kohë të shkurtër në kompanitë e ndryshme të profilit brenda dhe jashtë vendit dhe hedh bazat për zhvillimin e studimeve më të avancuara.
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale”, në përputhje me VKM 41, dt. 24.01.2018, është i organizuar sipas veprimtarive formuese si më poshtë [Evidencë 3 – 4 – 5, tabela 9]:
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	<ol style="list-style-type: none"> 1. lëndë bazë (A) – 36 ECTS (20%), 2. lëndë karakterizuese (B) – 93 ECTS (51.7%), 3. lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) 24 ECTS (13.3%), 4. lëndë plotësuese (D) – 21 ECTS (11.7%), 5. detyrime përmbyllëse (E) – 6 ECTS (3.3%). <p>Përsa i përket formave të mësimdhënies [RVB, tabela 13], ato janë të përqëndruara kryesisht tek leksionet (1242 orë) dhe seminarët (765 orë). Ushtrime dhe laboratore janë vetëm 45 orë. Gjithsej 2052 orë. Gjithashtu, në raportin orë/ECTS shihet tendenca e unifikimit të tij për format e ndryshme të mësimdhënies (mesatarisht 12.5 orë në auditor për ECTS).</p> <p>Nisur nga ky konstatim, profili inxhinierik i programit të studimit dhe takimeve online me drejtuesen e departamentit dhe GVB, GVJ rekomandon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Raporti orë/ECTS në auditor për format e ndryshme të mësimdhënies të rishikohet në përputhje me tabelën 5, në udhëzimin 15, dt. 04.04.2008,



	<p>2. Ndarja e veprimtarive jo vetëm në leksion/seminare, por në leksion/seminare/ushtrime/laboratore duke ju mundësuar studentëve zhvillimin e orëve praktike edhe brenda lëndëve të veçanta, dhe jo vetëm brenda lëndës “Praktikë profesionale”,</p> <p>3. Në kurrikulën e programit të konsiderohen orët e praktikave (1 ECTS = 20 – 25 orë në auditor) dhe orët e dedikuara diplomës (1 ECTS = 1 -2 orë në auditor) si orë në auditor për studentin,</p> <p>4. Evidentimin në kurrikul (jo vetëm në syllabuset e lëndëve) të krediteve të dedikuara detyrave të kursit/projekteve (1 ECTS = 1 -2 orë në auditor).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, si njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” përbëhet nga 6 Departamente dhe 1 Qendër Kërkimore Shkencore [Evidencë 3 – 4 – 5, tabela 1]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Biologjisë, - Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, - Departamenti i Shkencave Detare, - Departamenti i Shkencave Kompjuterike, - Departamenti i Matematikës, - Departamenti i Kimisë, - Qendra Kërkimore Shkencore. <p>Pranë DITD, si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi, në v.a. 2019 – 2020, janë të angazhuar si staf akademik efektiv 10 pedagogë (2 Prof. Asoc. Dr, 4 Dr. dhe 4 MSc.) [Evidencë 3 – 4 – 5, tabela 2].</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Përgjegjës për programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” është grupi mësimor – kërkimor [Evidencë II.2, Evidencë I.5, Neni 7] i Inxhinierisë Mekanike dhe Navale, nën drejtimin e përgjegjësit të emëruar nga Dekani [Evidencë II.3]. Nisur nga dokumentacioni i dorëzuar dhe nga takimet <i>online</i> në Departament, GVJ konstaton se përgjegjësi i grupit mësimor – kërkimor koordinon me përgjegjësën e Departamentit për mbarëvajtjen e veprimtarive mësimore dhe kërkimore të këtij programi studimi, duke qenë kështu edhe koordinor i tij.</p> <p>Përsa i përket praktikave profesionale, Departamenti ngre një komisionin për studimin për realizimin e praktikave mësimore [Evidencë I.16], i cili evidenton dhe vendos kontaktet me kompani të mundshme, pranë të cilave, studentët mund të zhvillojnë praktikat profesionale. Udhëheqësi i caktuar nga Departamenti koordinon punën me studentët.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe</p>	-

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Në vijim të përshkrimit në Kriterin 1 të këtij Standardi, FSHTN dhe DITD përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Gjatë v.a. 2019 – 2020, pranë FSHTN janë të angazhuar gjithsej 60 staf akademik efektiv, 7 staf akademik me kontratë dhe 13 staf administrativ. Pranë DITD, si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi, në v.a. 2019 – 2020, janë të angazhuar si staf akademik efektiv 10 pedagogë (2 Prof. Asoc. Dr, 4 Dr. dhe 4 MSc.) [Evidencë 3 – 4 – 5, tabela 2] dhe si staf akademik me kontratë 3 pedagogë (3 MSc.).			
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.				
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbajtje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (DITD) pranë Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore (FSHTN) në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë. DITD disponon të gjitha informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij programi studimi, në përputhje me statutin [Evidencë A] dhe rregulloren e Universitetit [Evidencë C], rregulloren e fakultetit [Evidencë I.4] dhe të departamentit [Evidencë I.5].
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale”, në përputhje me VKM 41, dt. 24.01.2018, është i organizuar sipas veprimtarive formuese si më poshtë [Evidencë 3 – 4 – 5, tabela 9]: <ol style="list-style-type: none"> 1. lëndë bazë (A) – 36 ECTS (20%), 2. lëndë karakterizuese (B) – 93 ECTS (51.7%), 3. lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) 24 ECTS (13.3%), 4. lëndë plotësuese (D) – 21 ECTS (11.7%), 5. detyrime përmblylëse (E) – 6 ECTS (3.3%). <p><i>Nisur nga profili inxhinierik i programit të studimit, GVJ rekomandon ndarjen e veprimtarive jo vetëm në leksion/seminare, por në leksion/seminare/ushtrime/laboratore duke ju mundësuar studentëve zhvillimin e orëve praktike edhe brenda lëndëve të veçanta, dhe jo vetëm brenda lëndës “Praktikë profesionale”.</i></p>
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite [Evidencë 3 – 4 – 5, tabela 10, Evidencë I.3, Neni 6, pika 1]. Krediti i formimit i referohet kreditit të formimit sipas Sistemit European të transferimit të krediteve (ECTS) dhe shpreh volumnin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore [Evidencë I.3, Neni 20].

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: www.ascal.al

	<p>Studimet në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë zhvillohen në bazë viti akademik, i cili organizohet në tre semestra:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Semestri i Vjeshtës, - Semestri i Pranverës, - Semestri i Verës. <p>Në ciklin e parë të studimeve, kohëzgjatja e semestrit të vjeshtës dhe pranverës është 15 javë kalendarike. Ngarkesa mësimore javore e studentit për çdo disiplinë, e ndarë në leksione, seminare, laboratorë dhe forma të tjera përcaktohen në planet mësimore [Evidencë C, Neni 45].</p>																				
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Në planin mësimor [Evidencë 3 – 4 – 5, tabela 10] të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” jepet ngarkesa e studentëve në auditor dhe jashtë tij për çdo aktivitet formues. Në syllabuset e lëndëve [Evidencë I], në përputhje me rregulloren e programit të studimit [Evidencë I.3, Neni 14] përcaktohet frekuentimi si i detyrueshëm deri në masën 75%. Në syllabuse gjithashtu, përshkruhet mënyra e vlerësimit të dijeve, e cila ndryshon nga njëra lëndë në tjetrën në përputhje me veprimtaritë e ndryshme të parashikuara.</p> <p>Vlerësimi me notë bëhet në bazë të konvertimit të vlerësimit total në %, nota 5 – 10 progresivisht 40 – 100%.</p> <table border="1" data-bbox="603 920 1412 987"> <thead> <tr> <th>Piket %</th> <th>0-20</th> <th>21-30</th> <th>31-39</th> <th>40-54</th> <th>55-65</th> <th>66-75</th> <th>76-85</th> <th>86-95</th> <th>96-100</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Nota</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>4</td> <td>5</td> <td>6</td> <td>7</td> <td>8</td> <td>9</td> <td>10</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>GVJ rekomandon që vlerësimi i provimit përfundimtar të jetë të paktën 60% e vlerësimit total, duke u bërë kështu përcaktues për kalimin ose jo me sukses të lëndës nga ana e studentit (me pikëzimin aktual të disa lëndëve, studenti mund të rezultojë kalues edhe vetëm me pikët e mbledhura gjatë vitit).</i></p>	Piket %	0-20	21-30	31-39	40-54	55-65	66-75	76-85	86-95	96-100	Nota	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Piket %	0-20	21-30	31-39	40-54	55-65	66-75	76-85	86-95	96-100												
Nota	2	3	4	5	6	7	8	9	10												
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në rregulloren e DITD [Evidencë I.5, Neni 15] dhe të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” [Evidencë I.3, Neni 19] përcaktohen kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit të studentëve në këtë program:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kanë të drejtë për t’u pranuar në programet e studimeve të ciklit të parë, kandidatët, të cilët kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me Vendim të Senatit Akademik të UV, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave. - Brenda afateve të përcaktuara nga Institucioni, DITD propozon kuotat dhe kriteret shtesë të pranimit të studentëve në programet e studimit të ciklit të parë të ofruara prej saj. <p>Nga takimet e zhvilluara <i>online</i> në Institucion, GVJ u informua se, nisur nga numri i vogël i aplikantëve në këtë program studimi, Departamenti gjatë viteve të fundit nuk ka aplikuar kriteret shtesë për përzgjedhjen e tyre.</p> <p>Në Kreun VI të rregullores së Universitetit [Evidencë C, Kreu VI], në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, përcaktohen të gjitha procedurat për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Departamenti, në shtator të çdo viti, ngre komisionin për shqyrtimin e dosjeve të studentëve të interesuar për transferim studimesh [Evidencë II.7].</p>																				

<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e detajuara të çdo lënde [Evidencë 1], bazuar në planin mësimor të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale”, risjellin informacionet e nevojshme për studentët lidhur me organizimin e tyre në leksione/seminare/laboratore, si dhe ngarkesën përkatëse javore brenda auditorit.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se elementët e përcaktuar në shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, dt. 24. 01. 2018 janë reflektuar në syllabuset e lëndëve.</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga takimet <i>online</i> e GVJ me stafin akademik dhe drejtuesen e Departamentit u konfirmua se nga ana e stafit dhe e departamentit bëhej një punë e vazhdueshme për përmirësimin e syllabuseve, brenda 20% të lejuar, në përputhje me ndryshimet më të fundit të fushës përkatëse. Ndryshimet diskutohen dhe miratohen në mbledhjet e departamentit para fillimit të vitit të ri akademik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Në vijim të standardit II.1, kriteri 5 dhe 6, në të cilat GVJ ka lënë edhe rekomandimet e tij, në tërësi, GVJ konstaton se organizimi i lëndëve/moduleve brenda kurrikulës është në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke mundësuar marrjen e njohurive dhe aftësive të nevojshme për krijimin e profilit të inxhinierit naval të aftë për tregun e punës.</p> <p>Kurrikula e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” është rishikuar në kuadër të projektit Tempus MARED në përputhje me rekomandimet e IMO (<i>International Maritime Organization</i>) [Evidencë 1.1], duke e bërë atë të transferueshëm dhe të njohur ndërkombëtarisht.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të</p>	



studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.									
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Nga takimet <i>online</i> të GVJ me stafin akademik dhe drejtuesen e Departamentit u konfirmua se nga ana e stafit dhe e departamentit bëhej një punë e vazhdueshme për përmirësimin e syllabuseve, brenda 20% të lejuar, në përputhje me ndryshimet më të fundit të fushës përkatëse, literaturës më të fundit në dispozicion të stafit akademik në gjuhën angleze dhe të përshtatur nga ta në shqip për studentët në formën e dispensave. Ndryshimet diskutohen dhe miratohen në mbledhjet e departamentit para fillimit të vitit të ri akademik.								
Kriteri 7. Përbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” ofron lëndë/module, të cilat formojnë studentin në drejtim të industrisë së shfrytëzimit dhe ndërtimit të anijeve duke i aftësuar për të ndjekur më tej studimet e ciklit të dytë në profilin përkatës. Nisur nga takimet <i>online</i> në Institucion, me stafin akademik dhe drejtuesen e Departamentit, GVJ konstatoi se mundësitë e punësimit brenda dhe jashtë vendit për këtë profil inxhinierik janë të shumta, por interesi nga ana e maturantëve mbetet akoma i ulët për shkak të vështirësive që paraqet natyra e punës në terren.								
Kriteri 8. Përbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	DITD bashkëpunon me institucione brenda dhe jashtë vendit për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale”. Një vend të veçantë zënë diskutimet me një partneritet të gjerë të zhvilluara në kuadër të projektit Tempus MARED të shoqëruar edhe me ndryshime në kurrikul, në përputhje me rekomandimet e IMO (<i>International Maritime Organization</i>) [Evidencë I.1].								
Kriteri 9. Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.									
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Gjatë v.a. 2019 – 2020, në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” janë të angazhuar në mësimdhënie 20 PAE (2 Prof. Asoc. Dr., 6 Dr., 6 Dr. Proc. dhe 6 MSc.) dhe 1 PAK (1 MSc.) [RVB, tabela 6.4]. <i>GVJ rekomandon përfshirjen në mësimdhënie brenda 30% të ngarkesës së lejuar të stafit akademik me kontratë, duke mundësuar, përmes tyre, sjelljen e eksperiencave të tjera jashtë Institucionit.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin	Bazuar në RVB [RVB, Tabela 12], syllabuset e lëndëve të vëna në dispozicion, të azhornuara në vazhdim të takimeve <i>online</i> në Institucion [Evidencë 1], si dhe nga takimet e zhvilluara me stafin akademik evidentohen lëndë, në të cilat pedagogu (lektori) i lëndës nuk mban gradën

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	shkencore Dr. ose titullin akademik Prof. Asoc./Prof.. (p.sh. lënda "Shfrytëzim, mirëmbajtje dhe riparim anije", pedagogu: MSc. Miranda Vidhaj).			
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Formimi i përgjithshëm i stafit akademik është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të programit të studimit dhe lëndëve specifike që ata mbulojnë [Evidencë I.9]. <i>Në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, GVJ rekomandon plotësimin e lektorëve për të gjitha lëndët me staf me grada dhe tituj shkencorë, duke angazhuar pedagogë me kontratë, ose duke nxitur stafin e angazhuar në marrjen e tyre.</i>			
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	DITD në kuadër të praktikave profesionale ngarkon staf akademik me kohë të plotë për koordinimin e punës me studentët. Drejtuesja e departamentit, gjatë takimeve <i>online</i> , konfirmoi, se pavarësisht mundësisë së krijuar për studentët e vitit të tretë me mesatare më të lartë për të zhvilluar temë diplome [Evidencë III.28], në vitet e fundit, asnjë student nuk ka zgjedhur mbylljen e studimeve me temë diplome. <i>GVJ rekomandon Departamentin të nxisë studentët e vitit të tretë, të cilët plotësojnë kushtet për mbylljen e studimeve me temë diplome, për zhvillimin e saj, duke mbështetur kështu edhe përfshirjen e studentëve në kërkim shkencor.</i>			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në kuadër të laboratoreve në nivel Departamenti dhe Qendrës Kërkimore të Fakultetit, Institucioni angazhon staf ndihmës akademik [Evidencë 3 – 4 – 5, tabela 1, Evidencë II.1] për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mbështetjen në zhvillimin korrekt të punëve laboratorike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një udhëzues të detajuar për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies duke u fokusuar në fushat e ndryshme të studimeve që ofron [Evidencë N]. Ndër objektivat kryesorë të këtij udhëzuesi është shqyrtimi, diskutimi dhe transferimi i praktikave më të mira të mësimdhënies duke synuar studentin në qendër, tendencat europiane të mësimdhënies, përdorimit më të gjerë të IT në mësimdhënie, përdorimi i platformës MOODLE etj.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSBCVI) [Evidencë III.1, Evidencë III.2], si strukturë përgjegjëse për cilësinë, ndjek procedurat për vlerësimin e performancës së stafit akademik dhe cilësinë e mësimdhënies përmes formularit drejtuar studentëve, miratuar me Vendim të Senatit Akademik [Evidencë III.3]. Formulari ju vihet në dispozicion studentëve për të dhënë mendimet e tyre [Evidencë III.4], çdo vit akademik, duke filluar nga viti akademik 2017 – 2018.</p> <p>Në vijim të mbledhjes së të dhënave nga studentët, NJSBCVI bën përpunimin statistikor dhe një analizë, shoqëruar me rekomandimet për përmirësimin e cilësisë. Raporti i hartuar nga NJSBCVI i përcillet njësive kryesore dhe bazë. Këto njësi i diskutojnë rezultatet në mbledhjet e hapura me stafin akademik duke dhënë propozimet përkatëse, të cilat diskutohen më tej në mbledhjen e radhës së Rektoratit. Rektorati mbi bazën e propozimeve të marra nga të gjitha njësitë harton planin e masave për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, i cili miratohet nga Senati Akademik [Evidencë III.5].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, trajtimit të ankimeve etj., përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - formularëve për cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e stafit akademik, - ankimit të rezultatit të vlerësimit të dijës sipas përcaktimeve në Rregulloren e Universitetit [Evidencë C, Neni 62], - adresimit dhe ankimit të shqetesimeve të studentëve përmes një adrese elektronike të posaçshme [Evidencë III.6]. <p><i>GVJ, nisur nga DVV dhe takimet online në Institucion, rekomandon futjen edhe të metodave të tjera me qëllim përfshirjen e studentëve në vlerësim, të tilla si fokus grupet, takimet peer - peer etj.</i></p>
<p>[Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</p>	<p>Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional publikon në faqen e Universitetit <i>online</i> raportin</p>

në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	përfundimtar të analizës së vlerësimit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e stafit akademik. Kjo analizë ju përcillet zyrtarisht të gjitha njësisve bazë, të cilat përcjellin vlerësimin individual tek secili pedagog.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	DITD diskuton raportin përmbledhës të formularëve të vlerësimit të mësimdhënies dhe performancës së stafit akademik të hartuar nga NJSBCVI, në mbledhjet e departamentit, duke evidentuar praktikat më të mira dhe duke hartuar plan masash për përmirësimin e pikave të dobëta. Rezultatet e pyetësorëve dhe analiza përkatëse në Departament bëhen pjesë e raportit vjetor të Departamentit [Evidencë I.7].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” format e mësimdhënies [RVB, tabela 13], janë të përqëndruara kryesisht tek leksionet (1242 orë) dhe seminarët (765 orë). Ushtrime dhe laboratore janë vetëm 45 orë. Gjithsej 2052 orë. <i>Nisur nga ky konstatim, profili inxhinierik i programit të studimit dhe takimeve online me drejtuesen e departamentit dhe GVB, GVJ rekomandon ndarjen e veprimtarive jo vetëm në leksion/seminare, por në leksion/seminare/ushtrime/laboratore/detyra kursi/projekte të evidentuara qartazi në kurrikulën e programit të studimit.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Nga takimet <i>online</i> me stafin dhe studentët e DITD, GVJ evidentoi një angazhim të mirë të stafit akademik për të ofruar forma dhe mënyra mësimdhënieje në përputhje me fushën e studimit dhe përshtatje të mirë të tyre edhe në kushtet e studimit <i>online</i> të diktuar nga emergjenca Covid – 19. Pavarësisht vështirësive nisur nga përmbajtja inxhinierike e lëndëve dhe moduleve, studentët u shprehën të kënaqur nga përpjekjet e stafit akademik për t’i bërë ato sa më të kuptueshme dhe të thjeshta për studentët.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Stafi akademik i DITD, falë projekteve në të cilat departamenti është i përfshirë si partner, në veçanti projekti Tempus MARED, në kuadër të të cilit është rishikuar edhe kurrikula e programit të studimit [Evidencë I.12], është azhurnuar me metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies në fushën e inxhinierisë navale, edhe falë infrastrukturës mbështetëse laboratorike të mundësuar nga këto projekte [Evidencë I.13, Evidencë I.14]. DITD disponon laboratorë simulimesh dhe matjesh në përputhje me lëndët që ofron. Në laboratorin e pajisur me kompjutera në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik janë instaluar <i>software</i> të ndryshëm inxhinierikë (Catia, MaxSurf, SAP, EngineRoom, etj.). Këto laboratorë mundësojnë implementimin e njohurive teorike përmes aplikimeve

	praktike, duke formuar konceptet e ndryshme të fushës përmes simulimeve, të cilat afrojnë studentin me situatat reale në profesion.			
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve falë formimit teoriko - praktik në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të programit të studimit dhe lëndëve specifike që ata mbulojnë [Evidencë 1.9]. Infrastruktura laboratorike në dispozicion të Departamentit mbështet mbarëvatjen e mësimdhënies dhe mësimnxënies.			
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Nga takimet e drejtëpërdrejta me stafin dhe studentët e DITD, GVJ evidentoi një bashkëpunim të mirë midis stafit akademik dhe studentëve në kuadër të mbarëvajtjes së procesit mësimor. Stafi akademik jo vetëm reflekton sugjerimet e dala nga vlerësimet e studentëve përmes formularit të vlerësimit, por gjithashtu përmes bisedimeve të hapura midis tyre. Nga takimet <i>online</i> në Institucion, me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se stafi akademik ishte shumë i kujdesshëm ndaj shqetësimeve të mundshme të studentëve, që lidhen edhe me vetë vështirësitë e lëndëve, duke synuar gjithmonë përgatitjen e materialeve sa më të qarta për ta dhe sjelljen e situatave reale duke i afruar me tregun e punës.			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Personeli akademik i përfshirë në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” angazhohet në zhvillimin e mësimi me metoda bashkëkohore aplikative me qëllim që të simulojë situatat reale, me të cilat i diplomuari në Inxhinieri Navale do të përballet në punën e tij të përditshme në kompanitë e ndryshme.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Falë infrastrukturës laboratorike të ofruar nga DITD dhe metodave mësimdhënëse me orientim aplikativ, përmes shembujve realë për çështjet e ndryshme të trajtuara, studenti në kohë të shkurtër fillon të bëhet autonom në trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme të inxhinierisë navale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3



Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Aktivitetet mësimore dhe kërkimore shkencore në kuadër të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” të ofruar pranë DITD, si pjesë e FSHTN, zhvillohen në ambjentet e Godinës C në korpusin universitar të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë [RVB, Tabela 16]. Sipërfaqja e mjediseve në dispozicion për studentët është gjithsej 3510 m ² , për stafin akademik 880 m ² . Norma m ² /student rezulton 3.56 m ² /student (në përmirësim të vazhdueshëm nisur edhe nga ulja e regjistrimeve gjatë viteve të fundit për disa nga programet e studimit të ofruara nga FSHTN, e

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	konfirmuar edhe nga përfaqësues të Fakultetit gjatë takimeve <i>online</i>), dhe norma m ² /staf rezulton 10 m ² /person. Gjatë vizitës <i>online</i> në Institucion, GVJ konstatoi që ambjentet e FSHTN ishin të pastra dhe të mirëmbajtura.
Kriteri 2. Ambjentet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Ambjentet e FSHTN janë të pajisura pjesërisht me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor [RVB, fq. 31]. <i>GVJ, nisur nga DVV dhe takimet online me stafin akademik dhe studentët, rekomandon pasurimin e klasave të FSHTN me pajisje të teknologjisë së informacionit (kompjuterat dhe video projektorë) për shfrytëzimin e tyre në kuadër të një mësimdhënie bashkëkohore.</i>
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Institucioni në mbështetje të realizimit me cilësi të procesit mësimor, vë në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve: - Platformën dixhitale “Sistemi i menaxhimit të informacionit mësimor të UV” [Evidencë III.12], - Internet wi – fi, - Adresat zyrtare për stafin dhe studentët. Pranë çdo njësie kryesore është i angazhuar një personel i strukturës së IT [Evidencë A, Neni 49, pika gj], në dispozicion të stafit dhe studentëve.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Nga takimet e zhvilluara <i>online</i> me stafin akademik dhe studentët e Departamentit, si dhe gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ konstatoi që pavarësisht fushës së veçantë të studimit, në dispozicion të studentëve janë vënë literaturë bazë dhe ndihmëse në formën e teksteve mësimore, ciklit të leksioneve (në formë të printuar apo elektronike) dhe tekste mësimore në gjuhë të huaj në formë elektronike.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Institucioni për të garantuar disponueshmëri të mjaftueshme të botimeve të viteve të fundit është regjistruar në librarinë dixhitale https://ulibrary.rash.al/ [Evidencë III.13]. Gjithashtu, në kuadër të planit kombëtar për dixhitalizimin e Bibliotekave Universitare, me lider Bibliotekën e Akademisë së Shkencave, Institucioni është angazhuar në dixhitalizimin e standardizuar dhe të unifikuar të tekstit mësimor dhe të artikujve shkencorë.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Një rëndësi të veçantë në kuadër të pasurimit të bibliotekës me literaturë bashkëkohore në fushën e navigacionit dhe detarisë zë fondi i librave të dhuruar nga kompania Petrolifera në bashkëpunim me Konsullatën e Përgjithshme të Italisë [Evidencë III.14].
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Nga vizita <i>online</i> në Institucion, GVJ konstatoi se DITD dhe FSHTN disponojnë laboratorë me infrastrukturë laboratorike bashkëkohore duke mundësuar një integrim shumë të mirë të mësimin teorik me atë praktik. Studentët angazhohen në punë laboratorike si brenda lëndëve, në kuadër të detyrave të kursit etj. edhe gjatë praktikave profesionale në fund të studimeve të tyre.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Institucioni ofron platformën dixhitale “Sistemi i menaxhimit të informacionit mësimor të UV” [Evidencë III.12], e shfrytëzuar gjerësisht nga stafi akademik, stafi administrativ dhe studentët për komunikim dhe shkëmbim të materialeve mësimore, studenti mund të njihet përmes tij me lëndët e programit të studimit përkatës, frekuentimin e tij për çdo lëndë, provimet që duhet të zhvillojë etj.
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë	Në këtë platformë, secili përdorues disponon hapësirën personale ku mund të aksesojë dokumentacionin elektronik përkatës.

sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.									
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Drejtuesja e departamentit, gjatë takimeve <i>online</i> , konfirmoi, se pavarësisht mundësisë së krijuar për studentët e vitit të tretë me mesatare më të lartë për të zhvilluar temë diplome [Evidencë III.28], në vitet e fundit, asnjë student nuk ka zgjedhur mbylljen e studimeve me temë diplome. <i>GVJ rekomandon Departamentin të nxisë studentët e vitit të tretë, të cilët plotësojnë kushtet për mbylljen e studimeve me temë diplome, për zhvillimin e saj, duke mbështetur kështu edhe përfshirjen e studentëve në kërkim shkencor.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	NJSBCVI është strukturë përgjegjëse për promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies, e cila bashkëpunon ngushtë me Fakultetet dhe Departamentet për promovimin e vazhdueshëm të kulturës së cilësisë në mësimdhënie tek stafet akademike dhe studentët.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	FSHTN dhe DITD, konkretisht zv. dekani për anën akademike, drejtuesja e Departamentit, si dhe drejtuesja e grupit mësimor të Inxhinierisë Mekanike dhe Navale, janë përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjen e vetëdijes të personelit akademik dhe studentëve lidhur me cilësinë e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale”. Këto struktura pasi njihen me materialin e përgatitur nga NJSBCVI mbi rezultatin e pyetësorëve drejtuar studentëve për cilësinë e procesit mësimor, përcjellin në strukturat përkatëse për miratim propozimet për planin e veprimit, i cili miratohet nga Senati Akademik dhe monitorohet nga NJSBCVI.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Institucioni ka hartuar një udhëzues të detajuar për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies duke u fokusuar në fushat e ndryshme të studimeve që ofron [Evidencë N]. Gjithashtu, në nivel institucioni është ngritur Qendra Studimore Ndërdisciplinore për Zhvillimin Rajonal, një prej qëllimeve të së cilës është mbështetja e metodave eksperimentale bashkëkohore.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar	Stafi akademik i angazhuar në kuadër të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale”, falë bashkëpunimeve dhe projekteve të DITD, kualifikohet në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor

Kamara

Gentiana

përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	në mbështetje të përmirësimit të mëtejshëm të mësimdhënies. Nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në DVV [Evidencë I.9], GVJ konstaton që stafi akademik nuk plotëson gjithmonë nevojat për grada dhe tituj shkencor.			
	GVJ rekomandon mxitjen dhe mbështetjen e stafit akademik në marrjen e gradave dhe titujve shkencorë.			
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Institucioni mbështet pjesëmarrjen e stafit akademik në aktivitete për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse dhe për implementimin e metodave të reja.			
	Nisur nga RVB dhe takimet online në institucion, GVJ konstaton se Institucioni vetë nuk organizon aktivitete të tilla. GVJ rekomandon organizimin e aktiviteteve trajnuese nga vetë Institucioni, me qëllim përmirësimin e aftësive mësimdhënëse të stafit akademik dhe implementimin e metodave të reja në mësimdhënie.			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik dhe ndihmës akademik i angazhuar në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale”, edhe falë infrastrukturës laboratorike bashkëkohore, implementon metoda të reja në mësimdhënie duke munduruar ndërthurjen e njohurive teorike me ato praktike.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Personeli akademik dhe ndihmës akademik përmes analizës së pyetësorëve të studentëve dhe komunikimeve të drejtëpërdrejta me ta, teston rezultatet e marra nga përdorimi i metodave të reja. Analiza e rezultateve raportohet dhe diskutohet në mbledhjet e Departamentit dhe të asamblesë së Fakultetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë përcakton kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive në: <ul style="list-style-type: none"> - Rregulloren e Institucionit [Evidencë C, Kreu VII], e publikuar edhe në faqen web të tij https://univlora.edu.al/rregullorja/, - Rregulloren e DITD [Evidencë I.5, Neni 18, 19], - Rregulloren e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” [Evidencë I.3, Neni 9], si dhe i paraqet të detajuara dhe të përshtatura për secilën lëndë në syllabuset përkatëse [Evidencë I]. Nga takimet <i>online</i> në Institucion, me stafin akademik dhe studentët, GVJ u vu në dijeni se në fillim të semestrit, pedagogët prezantojnë
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>syllabuset e lëndëve dhe format e ndryshme të vlerësimit të njohurive të shtrira përgjatë gjithë semestrit [Evidencë I].</p> <p><i>GVJ rekomandon që vlerësimi i provimit përfundimtar të jetë të paktën 60% e vlerësimit total, duke u bërë kështu përcaktues për kalimin ose jo me sukses të lëndës nga ana e studentit (me pikëzimin aktual të disa lëndëve, studentit mund të rezultojë kalues edhe vetëm me pikët e mbledhura gjatë vitit).</i></p>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Kontrolli i dijeve përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Ai realizohet përmes një provimi të pjesshëm, provimi final gjithë përfshirës, si dhe formave të tjera të specifikuar në syllabuset e lëndëve (kryesisht detyra kursi) [Evidencë I.3, Neni 9, Evidencë I].</p> <p>Nga takimet e zhvilluara <i>online</i> me studentët e këtij programi studimi, rezulton se mënyrat e kontrollit të dijeve të aplikuara për lëndët e ndryshme, i japin mundësi studentit të demonstrojë më së miri njohuritë dhe kompetencat e ofruara.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Sipas përcaktimeve në rregulloren e Institucionit [Evidencë C, Kreu VII], të pasqyruara në rregulloren e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” [Evidencë I.3, Neni 9], si dhe të detajuara në syllabuset e lëndëve [Evidencë I], testimi dhe vlerësimi i njohurive të studentëve shtrihet gjatë gjithë semestrit dhe realizohet përmes një provimi të pjesshëm, provimi final gjithë përfshirës, si dhe formave të tjera të specifikuar në syllabuset e lëndëve (kryesisht detyra kursi).
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Aktualisht, në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë nuk ka një sistem elektronik testimi dhe vlerësimi të studentëve, të cilat do të reduktonin abuzimet dhe do të rrisnin transparencën.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Nisur nga dokumentacioni i dorëzuar [Evidencë II.6] rezulton se komisionet e provimeve janë me 1 anëtar.
	<i>GVJ rekomandon ngritjen e komisioneve të provimeve me të paktën 2 anëtarë, duke rritur transparencën dhe objektivitetin e procesit.</i>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Testimi i vlerësimit të njohurive në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë nuk zhvillohet në mënyrë anonime. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit deri në shpalljen e rezultateve të provimit.
	<i>GVJ rekomandon zhvillimin me sekretim ose kodifikim të provimeve duke ruajtur anonimitetin në korrigjimin e tyre.</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga takimet <i>online</i> në Institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, përmes detyrave të kursit, provimeve të ndërmjetme, provimeve përfundimtare dhe në auditor gjatë seminareve dhe laboratoreve, shoqërohet me komente/feedback nga ana e pedagogëve, me qëllim këshillimin e studentëve për të ndihmuar në përmirësimin e tyre të vazhdueshëm.</p>			
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Pedagogu i lëndës/modulit apo komisioni i provimit janë hallka e parë përgjegjëse për shmangien e plagjiaturës, kopjimit në provime dhe detyra, në zbatim të rregullores së programit të studimit [Evidencë I.3, Neni 10] dhe respektimit të Kodit të Etikës të Universitetit “Ismail Qemali, Vlorë [Evidencë E, Neni 8, pika 6, 8, Neni 9, pika 8, 9].</p>			
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e provimeve hidhen nga pedagogët në sistemin e menaxhimit SMI – UniVlora, brenda 48 orësh nga orari i provimit përfundimtar [Evidencë C, Neni 61, Evidencë I.3, Neni 12, pika 2].</p> <p>Nga takimet <i>online</i> në Institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se vlerësimi i studentëve është korrekt dhe bazohet mbi performancën e tyre akademike gjatë vitit, në detyrat dhe provimet e dorëzuara. Gjithashtu, u konstatua se bëhej një punë e mirë nga stafi akademik për të evituar kopjet dhe plagjiaturat nga ana e studentëve.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të shohë tezën e tij individualisht dhe të kërkojë sqarime për korigjimin e saj nga pedagogu i lëndës. Nëse, pavarësisht sqarimeve nga ana e pedagogut, studenti mbetet i pasqaruar për vlerësimin, mund t’i drejtojë një kërkesë me shkrim sekretarisë së Departamentit. Në bazë të kësaj kërkesë, Departamenti ngre një komision <i>ad hoc</i> për vlerësimin e kërkesës së studentit. Pikët përfundimtare janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit [Evidencë I.3, Neni 12, pika 3 – 6].</p> <p>Nga takimet <i>online</i> në Institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se në kuadër të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” nuk ka patur raste të ngritjes së komisioneve <i>ad hoc</i> për rivlerësimin e studentëve pas apelimit të tyre.</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Nga takimet <i>online</i> në Institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se në kuadër të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” nuk ka patur raste të ngritjes së komisioneve <i>ad hoc</i> për rivlerësimin e studentëve pas apelimit të tyre.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” është i organizuar kryesisht në leksione (1242 orë) dhe seminare (765 orë). Ushtrime dhe laboratore janë vetëm 45 orë. Gjithsej 2052 orë.</p> <p>Nga takimet <i>online</i> me stafin akademik dhe studentët të këtij programi studimi, GVJ konkludon se bëhet një punë e mirë nga ana e stafit akademik për të garantuar thellimin e njohurive dhe zhvillimin e</p>






	<p>aftësive profesionale të studentëve në drejtim të disiplinave që lidhen me këtë profil studimit [Evidencë I.3, Neni 4]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - arkitekturë navale, - konstruksione navale, - projektimi i anijes, - shfrytëzimi i anijes. <p>Gjithashtu, ky program studimi, falë bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe infrastrukturës laboratorike në dispozicion, e aftëson studentin për të vazhduar studimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe është konform standardeve të parashikuara nga IMO model Course 7.04 dhe 7.02.</p> <p><i>GVJ rekomandon rishikimin e shpërndarjes së krediteve brenda lëndëve, duke përfshirë në kurrikul edhe veprimtaritë laborator dhe detyra kursi.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” garanton marrjen e njohurive të teknologjisë së informacionit, veçanërisht në drejtim të përdorimit të programeve simuluese të fushës së studimit. Gjithashtu, në kurrikulën e programit të studimit parashikohen njohuri të gjuhës angleze, të thelluara edhe në drejtim të terminologjisë së inxhinierisë navale.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Nga takimet <i>online</i> në Institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se analiza e kompetencave dhe aftësive të fituara nga studentët, të paraqitura në rregulloren e programit të studimit [Evidencë I.3, Neni 4] dhe syllabuset e lëndëve [Evidencë 1], bëhet në mënyrë të vazhduar përmes diskutimeve të drejtëpërdrejta me ta, anketimeve dhe vlerësimit përgjatë gjithë vitit.</p> <p>Gjithashtu, Institucioni ka filluar një praktikë të mirë duke organizuar workshopin “Studentët dhe tregu i punës” [Evidencë III.22], ku diskutohen kompetencat profesionale në një tryezë të përbashkët midis studentëve, pedagogëve dhe biznesit.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në përputhje me syllabuset e lëndëve [Evidencë 1], në përfundim të çdo lënde, personeli akademik diskuton çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre. Nga takimet <i>online</i> në Institucion, me studentë të këtij programi studimi, GVJ konstatoi se studentët ishin të kënaqur me komunikimin me pedagogët.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni organizon në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti leksione të hapura mbi zhvillimet më të fundit të shkencës dhe teknologjisë duke ftuar ekspertë të fushës, vendas dhe të huaj [Evidencë III.4].</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>DITD, falë infrastrukturës laboratorike që ka në dispozicion dhe bashkëpunimeve në kuadër të praktikave profesionale, mundëson ndërthurjen e njohurive teorike me ato praktike, duke e aftësuar studentin në drejtim të kërkesave të tregut të punës.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Nga takimet <i>online</i> në Institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se personeli akademik nxiti punën në grup, përmes</p>

<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>detyrave dhe diskutimeve, duke krijuar një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe studimeve të avancuara.</p> <p><i>GVJ, rekomandon nxitjen e studentëve për përfshirjen më të gjerë në kërkimin shkencor, përmes konferencave studentore dhe temave të diplomave.</i></p>			
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Nuk ka patur mbështetje financiare të Institucionit në kuadër të ideve inovative dhe studimeve të avancuara kërkimore dhe shkencore të studentëve [RVB, fq. 42].</p> <p><i>GVJ, rekomandon mbështetje financiare të ideve inovative dhe studimeve të avancuara kërkimore dhe shkencore të studentëve, të cilat do të jenë edhe nxitje për ta.</i></p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Nga takimet <i>online</i> në Institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se bëhet një punë e mirë nga personeli akademik për të ndërthurur format e mësimdhënies me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, me të cilat bashkëpunon, për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm ose me punim diplome [Evidencë I.3, Neni 17]. FSHTN vë në dispozicion të studentëve rregulloren e posatshme të diplomimit [Evidencë III.26]. Nga takimet <i>online</i> në Institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se procedura e diplomimit vihet në dispozicion të studentëve përmes publikimit të rregulloreve dhe këshilltarit akademik. Gjithashtu, në fund të semestrit të parë, zhvillohet një takim informues me studentët diplomantë për prezantimin e procedurës së diplomimit.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Sekretaria mësimore, pedagogu udhëheqës i temës së diplomës, si dhe pedagogët që kanë përgatitur bankën e pyetjeve të provimit të përgjithshëm [Evidencë III.27] asistojnë studentët duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme për mbarëvajtjen e tyre.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>DITD ngre një komision të posatshëm [Evidencë III.17], i cili është përgjegjës për përgatitjen dhe administrimin e bankës së pyetjeve të provimit të përgjithshëm, i cili i vihet në dispozicion studentëve të paktën 2 muaj përpara provimit [Evidencë III.27]. Ky provim bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë 3 viteve të studimit.</p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Personeli akademik i DITD, përgjegjës për hartimin e bankës së pyetjeve të provimit të përgjithshëm, orienton dhe ndihmon studentët në përgatitjen e tyre. Nga takimet <i>online</i> në Institucion, me studentë të këtij programi studimi, GVJ konstatoi se komunikimi me pedagogët ishte shume i mirë, në kuadër të lëndëve, provimeve, aktiviteteve etj. Kjo edhe për faktin që numri i studentëve është i ulët, duke ju mundësuar pedagogëve disponueshmëri ndaj studentëve për çdo problematike që mund të lindë.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Drejtuesja e departamentit, gjatë takimeve <i>online</i>, konfirmoi, se pavarësisht mundësisë së krijuar për studentët e vitit të tretë me mesatare më të lartë për të zhvilluar temë diplome [Evidencë III.28], në vitet e fundit, asnjë student nuk ka zgjedhur mbylljen e studimeve me temë diplome.</p>			
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p><i>GVJ rekomandon Departamentin të nxisë studentët e vitit të tretë, të cilët plotësojnë kushtet për mbylljen e studimeve me temë diplome, për zhvillimin e saj, duke mbështetur kështu edhe përfshirjen e studentëve në kërkim shkencor.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit të përgjithshëm ose mbrojtjes së diplomës studenti vlerësohet me notë [Evidencë III.26, Neni 10].</p>			
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare [Evidencë I.3, Neni 18, pika 4], studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin [Evidencë III.30].</p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Me kërkesë të tij, studentit të diplomuar i vihet në dispozicion programi i plotë i studimit në gjuhën shqipe dhe angleze.</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Sekretaria mësimore mban regjistrin bazë të studentëve me të dhëna personale, vlerësimet përkatëse gjatë studimeve, të dhëna mbi diplomën dhe suplementin e diplomës, të formatuara sipas standardeve shtetërore [Evidencë C, Neni 54]. Këto të dhëna vihen në dispozicion të strukturave përkatëse, në përputhje me ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri" [Evidencë C, Neni 90].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X



<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


Standardi IV.1				
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll – Arkivës [Evidencë C, Neni 89], si pjesë e Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale”. Ky sektor disponon një dosje të plotë, e cila përditësohet në vazhdimësi, për secilin anëtar të personelit akademik, përgjegjësin e programit, stafin ndihmës akademik dhe administrativ.			
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	DITD në fillim të çdo viti akademik paraqet nevojat për staf akademik nisur nga analiza e ngarkesës mësimore, të cilat përcillen në Rektorat për shqyrtim dhe miratim [Evidencë C, neni 29]. Pas vlerësimit dhe miratimit të kërkesave [Evidencë A, Neni 51], bëhet publikimi i vendeve vakante në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen web të Universitetit [Evidencë IV.1].			
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Në statutin e Universitetit [Evidencë A, Neni 38, pika e, f, j, Neni 51, Evidencë C, Neni 28, 29] përcaktohen procedurat për rekrutimin e stafit akademik, duke nisur nga paraqitja e nevojave të Departamentit dhe përcjellja e tyre në Rektorat, miratimi i kritereve që duhet të plotësojnë kandidatët, publikimi i vendeve vakante, përzgjedhja nga komisioni <i>ad hoc</i> për konkursin e rekrutimit dhe së fundi, vendimi i marrjes në punë nga rektori. Procedura dokumentohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll – Arkivës.			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni, në përputhje me ligjin 80/2015, Statutin dhe Rregulloren e Institucionit përcakton kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e stafit akademik. Kriteret specifike propozohen nga Departamenti, në përputhje me specifikat e grup – lëndëve, për të cilat janë shpallur nevojat për rekrutim të stafit të ri akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshatshme dhe të barabarta për	Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” të ofruar pranë DITD, si pjesë e FSHTN, zhvillon aktivitetet e tij në ambientet e Godinës C në korpusin universitar të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al






kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë [RVB, Tabela 16]. Ambjentet në dispozicion të stafit akademik janë të përshtatshme për zhvillimin korrekt të të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore – shkencore dhe administrative (norma m ² /staf rezulton 10 m ² /person).			
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Stafi akademik i angazhuar në kuadër të programit të studimit <i>Bachelor</i> në "Inxhinieri Navale", falë bashkëpunimeve dhe projekteve të DITD, kualifikohet në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor në mbështetje të përmirësimit të mëtejshëm të mësimdhënies. <i>GVJ rekomandon mxitjen dhe mbështetjen e stafit akademik në marrjen e gradave dhe titujve shkencorë.</i>			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Institucioni ka hartuar një udhëzues të detajuar për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies duke u fokusuar në fushat e ndryshme të studimeve që ofron [Evidencë N]. Gjithashtu, në nivel institucioni është ngritur Qendra Studimore Ndërdisciplinore për Zhvillimin Rajonal, një prej qëllimeve të së cilës është mbështetja e metodave eksperimentale bashkëkohore.			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Nga takimet e zhvilluara <i>online</i> në Institucion, GVJ konstatoi se ka një angazhim të mirë të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimit të ciklit të parë <i>Bachelor</i> në "Inxhinieri Navale". Gjatë v.a. 2019 – 2020, në këtë program studimi janë angazhuar në mësimdhënie 20 PAE (2 Prof. Asoc. Dr., 6 Dr., 6 Dr. Proc. dhe 6 MSc.) dhe 1 PAK (1 MSc.) [RVB, tabela 6.4]. <i>GVJ rekomandon përfshirjen në mësimdhënie brenda 30% të ngarkesës së lejuar të stafit akademik me kontratë, duke mundësuar, përmes tyre, sjelljen e eksperiencave të tjera jashtë Institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Aktivitetet mësimore dhe kërkimore shkencore në kuadër të programit të studimit <i>Bachelor</i> në "Inxhinieri Navale" të ofruar pranë DITD, si pjesë e FSHTN, zhvillohen në ambjentet e Godinës C në korpusin universitar të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë [RVB, Tabela 16]. Ambjentet në dispozicion janë të mjaftueshme për mbarëvajtjen e veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të këtij programi studimi.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes	Ambjentet e FSHTN janë të pajisura pjesërisht me logjistikën e nevojshme të teknologjisë së informacionit për realizimin me cilësi të procesit mësimor [RVB, fq. 31].

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ, nisur nga DVV dhe takimet online me stafin akademik dhe studentët, rekomandon pasurimin e klasave të FSHTN me pajisje të teknologjisë së informacionit (kompjuterat dhe video projektorë) për shfrytëzimin e tyre në kuadër të një mësimdhënie bashkëkohore.			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vizita <i>online</i> në Institucion, GVJ konstatoi se DITD dhe FSHTN disponojnë laboratorë me infrastrukturë laboratorike bashkëkohore duke mundësuar një integrim shumë të mirë të mësimin teorik me atë praktik, për arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.			
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	GVJ, nisur nga DVV dhe takimet online me stafin akademik dhe drejtuesen e Departamentit, rekomandon Institucionin të krijojë mundësinë e ambjenteve të përshtatshme për vendosjen e bazës laboratorike në dispozicion të DITD.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	DITD realizon praktikat profesionale në bashkëpunim me kompani të ndryshme publike dhe private, me të cilat bashkëpunon dhe që zhvillojnë aktivitetet e tyre në fushën e inxhinierisë navale, pranë kompanive, të cilat operojnë në fushën e ndërtimit dhe riparimit të anijeve, ndërmarrjeve të industrisë navale, autoriteteve portuale, shoqërive të shfrytëzimit dhe menaxhimit të anijeve [RVB, fq. 12].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Në dispozicion të studentëve të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” janë dy biblioteka, ajo e Fakultetit në Godinën C dhe Biblioteka qendrore në Godinën A. Sallat janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme duke krijuar hapësira të përshtatshme për studim.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Literatura fizike në gjuhën shqipe në dispozicion për studentët në dy bibliotekat, në Godinën A dhe C, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e lëndëve/moduleve në kuadër të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” [Evidencë IV.3]. Në takimet <i>online</i> në Institucion, në vizitën në Bibliotekë, GVJ u informua mbi materialet e ndryshme mësimore në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik të këtij programi studimi.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat	Institucioni është regjistruar në librarinë dixhitale https://ulibrary.rash.al/ [Evidencë III.13], e vënë në dispozicion për studentët dhe stafin akademik pa pagesë.



Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

on-line të fushës së programit të studimit.									
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Gjatë vizitës <i>online</i> në Institucion, GVJ konstatoi se Biblioteka qendrore në Godinë A, është e pajisur me kompjutera të aksesueshëm nga studentët duke mundësuar shfrytëzimin pa kufizime të literaturës elektronike në dispozicion. Gjithashtu, Institucioni është angazhuar në dixhitalizimin e standardizuar dhe të unifikuar të tekstit mësimor dhe të artikujve shkencorë, në kuadër të planit kombëtar për dixhitalizimin e Bibliotekave Universitare, me lider Bibliotekën e Akademisë së Shkencave.								
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Institucioni, çdo vit, përpara hartimit të buxhetit vjetor, kërkon prej Njësive Bazë të përcjellin nevojat për pasurimin e literaturës në përputhje me përditësimet e syllabuseve të lëndëve. Në vijim, në buxhet dedikohet një zë i veçantë për këtë investim.								
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka qendrore, në Godinë A, është në dispozicion të studentëve nga e hëna në të premte, në orarin 08:00 – 20:00. Biblioteka e godinës C qëndron e hapur nga e hëna në të premte, në orarin 08:00 – 16:00.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nga vizita <i>online</i> në Institucion, GVJ konstatoi se Institucioni, në zbatim të ligjit 80/2015, mban të dhënat e studentëve në formë të shkruar në: <ul style="list-style-type: none"> - Regjistrin themeltar të studentëve; - Regjistrin e arritjeve akademike; - Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Sekretaritetë mësimore të departamenteve i plotësojnë këto regjistra edhe në formë elektronike. Institucioni, gjithashtu, ka vendosur në dispozicion të stafit akademik, administrativ dhe studentëve platformën dixhitale “Sistemi i menaxhimit të informacionit mësimor të UV” [Evidencë III.12], i cili mundëson shërbimet e nevojshme sipas grupeve të përdoruesve.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore menaxhon dokumentacionin personal të stafit, ndjek procedurat për kontratat e punës, hedh të dhënat e çdo punonjësi në regjistrin themeltar, nxjerr të dhëna nga dosjet e personelit kur kërkohen bazuar në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale [Evidencë C. Neni 90]. Sistemi i mbajtjes së këtyre të dhënave nuk është akoma në proces dixhitalizimi.



Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit të informacionit mësimor të UV, siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumentacion për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale”. Përmes këtij sistemi, stafi akademik vë në dispozicion të studentëve materialet mësimore të nevojshme gjatë lëndëve/moduleve. Studentët njihen me lëndët, provimet që duhet të zhvillojnë, frekuentimin e tyre, ecurinë e studimeve, njoftime të ndryshme etj.			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit të informacionit mësimor të UV operon mbi bazën e moduleve të ndryshme, duke mundësuar shërbimet e nevojshme për çdo grup përdoruesish. Çdo input informacioni shoqërohet me shkresat përkatëse, sipas procedurave të Institucionit, të përcaktuara në rregulloren e tij [Evidencë C].			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi i menaxhimit të informacionit mësimor të UV garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale [Evidencë III.16].			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen <i>web</i> të Universitetit në gjuhën shqipe dhe angleze https://univlora.edu.al/ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni harton në mënyrë periodike raportin financiar, i cili paraqitet për miratim si pjesë e raportit vjetor pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Në këtë analizë financiare pasqyrohen kostot financiare mesatare për student në nivel universiteti. Përmes planifikimit të buxhetit për çdo vit pasardhës, i cili realizohet në mënyrë periodike, si rregull në përfundim të vitit, hartohet edhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për programin e studimit për vitin pasardhës, si dhe hartohet buxheti afatmesëm, i cili mbulon një periudhë tre vjeçare, i cili jep mundësinë për një plan mbështetje financiare për të paktën një cikël të plotë studimi [Evidencë IV.6].
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit	Institucioni nuk harton një plan financiar të dedikuar për një program studimi specifik, por ky plan vjen si pjesë integrale e planit financiar të vetë institucionit dhe përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës,

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të fituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë lidhur me të [Evidencë IV.5].</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni i nënshtrohet auditit financiar të brendshëm dhe të jashtëm. Auditimi i jashtëm kryhet nga MASR dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit. Raportet financiare përmbajnë tabelën për të ardhurat dhe ndarjen e burimeve financiare, të cilat janë të detajuara për çdo vit dhe të miratura nga organet kolegjiale. Raportet gjenden të certifikuar në nga Dega e Thesarit Vlorë në faqet online (https://univlora.edu.al/, https://panel.utransparenca.al/) të detajuara në raporte mujore me përshkrimin: Akordimi i të ardhurave. Situacioni i shpenzimeve [Evidencë IV.5].</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Institucioni, në fund të çdo viti, bën një analizë financiare, e cila jo vetëm përshkruan peiudhën e caktuar, por bën edhe një analizë krahasuese për shumicën e zërave të buxhetit, duke nxjerr konkluzione lidhur me raportet financiare të tre viteve të fundit akademike dhe mbi bazën e tyre mund të planifikojë ndërhyrje të posaçme dhe ndryshim të mundshëm të financimeve të programeve të studimit për të garantuar mbarëvajtjen e tyre [Evidencë J].</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Burimet e financimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë janë [Evidencë I, Evidencë J]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Granti që akordohet nga MASR, - Fondet e vetë Universitetit nga tarifat e regjistrimit dhe shkollimit të studentëve, - Të ardhura nga shërbime të tjera që ofron Institucioni. <p>Me qëllim mirëmenaxhimit e këtyre fondeve dhe sigurimin e qëndrueshmërisë financiare, gjatë analizës financiare vjetore shqyrtohet edhe realizimi i treguesve mbi zbatimin e politikës financiare të Institucionit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	------------------------------	------------------------------	-----------------------------	--






V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni zbaton politika dhe procedura, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të barabarta, për të gjithë kandidatët për studentë, duke mundësuar ndjekjen korrekte të kandidatit që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomim të tij, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të saksionuara edhe në rregulloret e brendshme të Institucionit [Evidencë C. Kreu V - VIII].
Kriteri 2. Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, transferimi i studimeve nga një Institucion tjetër i arsimit të lartë, njohja dhe transferimi i krediteve të fituara në studimet e mëparshme, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi, janë të shprehura qartë në rregulloren e Institucionit [Evidencë C. Kreu V - VIII] dhe janë lehtësisht të aksesueshme nga studentët.
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Institucioni, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të saksionuara edhe në rregulloret e brendshme të Institucionit [Evidencë C. Kreu V - VIII], harton dhe publikon përpara fillimit të vitit akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve të ciklit të parë të studimeve, të propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga Senati Akademik [Evidencë II.4, Evidencë V.3]. Në programin e studimit <i>Bachelor</i> në "Inxhinieri Navale" kanë të drejtë të aplikojnë shtetasit shqiptar dhe të huaj, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm ose profesional, plotësojnë kushtin e notës mesatare të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe kriteret e pranimit të përcaktuara nga Institucioni për programin e studimit. Për kandidatët, të cilët kanë diplomë të shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, bëhet ekuivalentimi i diplomës nga strukturat përkatëse të MASR.
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Nga takimet online në Institucion, GVJ konstatoi se për pranimin e studentëve në programin e studimit <i>Bachelor</i> në "Inxhinieri Navale" nuk ka kriteret të veçanta, nisur nga numri i ulët i aplikimeve. Rradhitja e studentëve bëhet mbi bazën e notës mesatare dhe lëndëve me zgjedhje karakterizuese të programit.
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Institucioni përmes Sektorit të Këshillimit dhe Karrierës, Alumnit dhe grupeve të informimit të maturantëve në Fakultete [Evidencë V.4], përpara plotësimit të formularëve të aplikimit të maturantëve organizon, në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore, takime promovuese dhe ditë të hapura me kandidatët për studentë në Qarkun e Vlorës dhe më gjerë, për t'i informuar në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p>pranimit në programet e studimit të ofruara nga Institucioni. Gjatë ditëve informuese, DITD përfaqësohet me stafin e tij akademik dhe materialet promovuese për programet e studimit që ofron [Evidencë V.5, Evidencë V.6].</p> <p>Gjatë vizitës <i>online</i> në Institucion, GVJ konstatoi se pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19, Institucioni është angazhuar në informimin e vazhdueshëm të kandidatëve për studentë mbi programet e studimit që ofron.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në fillim të vitit akademik, Institucioni njih studentët e regjistruar me kriteret dhe procedurat e përparimit të tyre akademik [Evidencë C, Neni 75 – 77]. Studentët mund të njihen përmes Sistemit të menaxhimit të informacionit mësimor të UV me procedurat e përparimit akademik, si dhe marrjen e shërbimeve të tjera, si prenotimi i një provimi etj. Lista e notave dhe vërtetim i studentit merren pranë sekretarisë mësimore.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në rastet e transferimit të studimeve, dosja e kandidatit shqyrtohet nga një komision <i>ad hoc</i> , i ngritur nga Departamenti, në shtator të çdo viti, [Evidencë II.7], në përputhje me rregulloren e Institucionit [Evidencë C, Kreu VI]. Kriteret dhe procedurat e aplikimit për transferim studimesh mbështeten në udhëzimet përkatëse të MASR dhe bëhen publike nga Institucioni për të interesuarit.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në fillim të çdo semestri, studentët njihen nga pedagogët e lëndëve me përmbajtjen e syllabuseve, si dhe format e ndryshme të vlerësimit të dijeve [Evidencë I].
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm ose me punim diplome [Evidencë I.3, Neni 17]. FSHTN vë në dispozicion të studentëve rregulloren e posatshme të diplomimit [Evidencë III.26]. Nga takimet <i>online</i> në Institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se procedura e diplomimit vihet në dispozicion të studentëve përmes publikimit të rregulloreve dhe këshilltarit akademik. Gjithashtu, në fund të semestrit të parë, zhvillohet një takim informues me studentët diplomantë për prezantimin e procedurës së diplomimit.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të	Institucioni, me kordinimin e Drejtorisë së Edukimit për Ciklin e I dhe të II, përpara fillimit të vitit akademik dhe në mënyrë periodike

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

interesarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	organizon aktivitete për informimin e të interesuarve për programet e studimit që ofron: <ul style="list-style-type: none"> - Open day; - Welcome day [Evidencë V.8]; - Takime për këshillim karriere [Evidencë V.4]; - Panair pune [Evidencë V.9]; - Njoftime punësimi për internship; - Vizita nga zyrat “peer to peer”; - Udhëzues ose fletëpalosje me shërbimet e Institucionit [Evidencë V.5]. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët e regjistruar në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale”, njihen gjatë takimeve në ditën e parë të vitit akademik [Evidencë V.8] me drejtuesen e Departamentit, përgjegjësen e grupit mësimor, pedagogët e angazhuar në kuadër të tij, koordinatorin për marrëdhënien me studentët dhe përfaqësues të Sektorit të kurrikulave dhe mbështetjes së studentëve në nivel Fakulteti, me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në fillim të çdo semestri, studentët njihen nga pedagogët e lëndëve me përmbajtjen e syllabuseve [Evidencë I]. FSHTN vë në dispozicion të studentëve rregulloren e posatshme të diplomimit [Evidencë III.26].
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	DITD informon në vazhdimësi, studentët mbi mundësitë e punësimit të ofruara në fushën e inxhinierisë navale në rajon dhe më gjerë. Institucioni përmes Sektorit të Këshillimit dhe Karrierës, Alumnit realizon aktivitete me qëllim prezantimin e mundësive të punësimit të tilla si Panairi i punës etj. [Evidencë V.9].
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve në ambjentet e Universitetit, në faqen e saj <i>online</i> dhe në Sistemin e menaxhimit të informacionit mësimor të UV, të dhëna mbi orarin, aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, si dhe çdo informacion tjetër në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor.
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë	




lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.																																																		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht																																														
				X																																														
Standardi V.4																																																		
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm																																																		
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																	
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Sekretaria mësimore e DITD ruan dhe përditëson, në formë elektronike dhe <i>hardcopy</i> , në regjistrat sipas formateve të miratuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin, të dhënat për studentët nga regjistrimi i tyre deri në diplomim. Kjo mundëson realizimin e raporteve të ndryshme statistikore mbi vijueshmërinë, ndërprerjen, largimin dhe përfundimin e studimeve.																																																	
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Nga të dhënat e vëna në dispozicion [RVJ, tabela 21], GVJ konstaton, të dhënat përmbledhëse mbi cilësinë e studentëve të regjistruar në 3 vitet e fundit, si më poshtë:																																																	
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Sipas Viteve akademike</th> <th rowspan="2">Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)</th> <th rowspan="2">Nota mesatare në hyrje</th> <th colspan="3">Studentë të transferuar sipas viteve (b)</th> <th rowspan="2">Studentë të transferuar Brezat (b)</th> <th rowspan="2">Totali: (a)+(b)</th> </tr> <tr> <th>Viti I</th> <th>Viti II</th> <th>Viti III</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2017 - 2018</td> <td>10</td> <td>6.74</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>11</td> </tr> <tr> <td>2018 - 2019</td> <td>15</td> <td>6.68</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>15</td> </tr> <tr> <td>2019 - 2020</td> <td>5</td> <td>6.56</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td>31</td> </tr> </tbody> </table>							Sipas Viteve akademike	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar sipas viteve (b)			Studentë të transferuar Brezat (b)	Totali: (a)+(b)	Viti I	Viti II	Viti III	2017 - 2018	10	6.74	1	0	0	1	11	2018 - 2019	15	6.68	0	0	0	0	15	2019 - 2020	5	6.56	0	0	0	0	5	Total							31
Sipas Viteve akademike	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar sipas viteve (b)			Studentë të transferuar Brezat (b)	Totali: (a)+(b)																																											
			Viti I	Viti II	Viti III																																													
2017 - 2018	10	6.74	1	0	0	1	11																																											
2018 - 2019	15	6.68	0	0	0	0	15																																											
2019 - 2020	5	6.56	0	0	0	0	5																																											
Total							31																																											
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Dhe të dhënat mbi diplomimin dhe punësimin e të diplomuarve si mëposhtë [Evidencë 3 – 4 – 5, tabela 23]:																																																	
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Sipas Viteve akademike</th> <th colspan="3">Periodha e të dhënave 2016 - 2019</th> </tr> <tr> <th>Numri total të diplomuarve</th> <th>Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)</th> <th>Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2016 - 2017</td> <td>13</td> <td rowspan="3">8</td> <td rowspan="3">14</td> </tr> <tr> <td>2017 - 2018</td> <td>23</td> </tr> <tr> <td>2018 - 2019</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>45</td> <td>8</td> <td>14</td> </tr> </tbody> </table>							Sipas Viteve akademike	Periodha e të dhënave 2016 - 2019			Numri total të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)	2016 - 2017	13	8	14	2017 - 2018	23	2018 - 2019	9	Total	45	8	14																								
Sipas Viteve akademike	Periodha e të dhënave 2016 - 2019																																																	
	Numri total të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)																																															
2016 - 2017	13	8	14																																															
2017 - 2018	23																																																	
2018 - 2019	9																																																	
Total	45	8	14																																															
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<i>Nisur nga të dhënat e kufizuara mbi punësimin e të diplomuarve, GVJ rekomandon Institucionin të forcojë lidhjen me alumnit duke mundësuar gjurmimin e punësimit të tyre të paktën për të diplomuarit në 3 vitet e fundit.</i>																																																	
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht																																														
			X																																															

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi V.5				
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Përfaqësuesit e studentëve, në përputhje me statutin e Institucionit [Evidencë A, Kreu VII], janë pjesë e Senatit Akademik, Bordit të Administrimit dhe komisioneve të përhershme [Evidencë V.11]. Institucioni mbështet dhe nxit pjesëmarrjen e studentëve në vendimarrje, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.			
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.				
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Institucioni në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit kujdeset që të mundësojë transferimin e studimeve në hyrje dhe në dalje nga programe të ngjashme brenda dhe jashtë vendit. Kurrikula e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale” është rishikuar brenda 20%, në kuadër të projektit Tempus MARED në përputhje me rekomandimet e IMO (<i>International Maritime Organization</i>) [Evidencë I.1], duke e bërë atë të transferueshëm dhe të njohur ndërkombëtarisht.			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, mundëson dhënie e mendimit të tyre mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të dijeve, trajtimit të ankimeve etj., përmes: <ul style="list-style-type: none"> - formularëve për cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e stafit akademik [Evidencë III.3], - ankimit të rezultatit të vlerësimit të dijes sipas përcaktimeve në Rregulloren e Universitetit [Evidencë C, Neni 62], - adresimit dhe ankimit të shqetesimeve të studentëve përmes një adrese elektronike të posatshme [Evidencë III.6], - pjesëmarrja e tyre aktive në strukturat vendimmarrëse të Institucionit 			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X



Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Struktura përgjegjëse në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, e cila në përputhje me aktet e brendshme rregullatore [Evidencë A, Neni 77, Evidencë C], informon dhe mbështet studentët është Drejtoria e Edukimit për ciklin e I dhe të II me dy sektorë: Sektori i Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve dhe Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore - Sportive.								
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sistemi i informimit, këshillimit dhe ndjekjes së përparimit të studentëve është i organizuar nga strukturat si mëposhtë: <ul style="list-style-type: none"> - Sekretaria mësimore, - Koordinatori për marrëdhënien me studentin në nivel Departamenti, - Sektori i Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve, - Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore - Sportive. 								
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore – Sportive është një urë lidhëse midis studentit dhe tregut të punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencialë. Nga takimet <i>online</i> në Institucion, GVJ konstatoi se, Departamenti realizonte konkretisht këshillimin e orientuar të karrierës për studentët në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale”.								
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore – Sportive është struktura përgjegjëse për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave të punësimit të të diplomuarve. Nisur nga të dhënat e vëna në dispozicion mbi punësimin e të diplomuarve [Evidencë 3 – 4 – 5, tabela 23], dhe nga takimet <i>online</i> në Institucion, GVJ konstaton se këto të dhëna janë të kufizuara. Në kuadër të pasurimit të tyre, Institucioni ka hartuar një formular regjistrimi <i>online</i> të të diplomuarve https://univlori.edu.al/alumni/ . <i>GVJ rekomandon Institucionin të forcojë lidhjen me alumnit duke mundësuar gjurmimin e punësimit të tyre të paktën për të diplomuarit në 3 vitet e fundit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni ka ngritur, në varësi të Rektorit, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBCVI) [Evidencë A, Neni 82, Evidencë III.11], e cila ka si funksion kryesor bashkëpunimin për realizimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim – shkencor, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në planin strategjik të zhvillimit të Institucionit 2018 – 2024 [Evidencë B, fq. 30], në Skenarin II – Universiteti Smart, parashikohet përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies përmes shfrytëzimit efektiv të instrumentave të teknologjisë së informacionit. Nisur nga RVB dhe takimet <i>online</i> në Institucion, GVJ konstatoi se pavarësisht ngritjes së strukturave të sigurimit të cilësisë në nivel Institucioni dhe Fakulteti, ato nuk janë të plotësuara me staf. Kjo mangësi vihet re në metodat e kufizuara të matjes së cilësisë së veprimtarive akademike, vetëm përmes pyetësorëve drejtuar studentëve dhe një bashkëpunim të dobët dhe shpeshherë jo funksional midis Njësive Kryesore/Njësive Bazë dhe NJSBCVI.</p> <p><i>GVJ rekomandon Institucionin në plotësimin e komisioneve dhe strukturave të tjera të sigurimit të cilësisë në nivel Institucioni dhe Fakulteti me staf, për të mundësuar funksionimin më të mirë të tij.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni i është nënshtruar akreditimit të jashtëm institucional dhe ka filluar procedurat për akreditimin e programeve të studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Institucioni në fund të çdo semestri, përpara periudhës së provimeve, organizon pyetësorët me studentët për cilësinë e procesit mësimor.</p> <p><i>GVJ, nisur nga DVV dhe takimet online në Institucion, rekomandon futjen edhe të metodave të tjera të matjes së cilësisë, pyetësorë drejtuar stafit akademik, stafit administrativ, fokus grupet drejtuar studentëve, takimet peer - peer etj.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Struktura përgjegjëse në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, e cila monitoron, shqyrton, mbikëqyr, rishikon programet e studimit të ciklit të parë, është Drejtoria e Edukimit për ciklin e I dhe të II përmes Sektorit të Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve.								
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	NJSBCVI [Evidencë III.1, Evidencë III.2], si strukturë përgjegjëse për cilësinë, ndjek procedurat për vlerësimin e performancës së stafit akademik dhe cilësinë e mësimdhënies përmes formularit drejtuar studentëve, miratuar me Vendim të Senatit Akademik [Evidencë III.3]. Formulari ju vihet në dispozicion studentëve për të dhënë mendimet e tyre [Evidencë III.4], çdo vit akademik, duke filluar nga viti akademik 2017 – 2018.								
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Në vijim të mbledhjes së të dhënave nga studentët, NJSBCVI bën përpunimin statistikor dhe një analizë, shoqëruar me rekomandimet për përmirësimin e cilësisë. Raporti i hartuar nga NJSBCVI i përcillet njësive kryesore dhe bazë. Këto njësi i diskutojnë rezultatet në mbledhjet e hapura me stafin akademik duke dhënë propozimet përkatëse, të cilat diskutohen më tej në mbledhjen e radhës së Rektoratit. Rektorati mbi bazën e propozimeve të marra nga të gjitha njësitë harton planin e masave për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, i cili miratohet nga Senati Akademik [Evidencë III.5].								
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	DITD diskuton raportin përmbledhës të formularëve të vlerësimit të mësimdhënies dhe performancës së stafit akademik të hartuar nga NJSBCVI, në mbledhjet e departamentit, duke evidentuar praktikën më të mira dhe duke hartuar plan masash për përmirësimin e pikave të dobëta. Rezultatet e pyetësorëve dhe analiza përkatëse në Departament bëhen pjesë e raportit vjetor të Departamentit [Evidencë I.7].								
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	<i>GVJ, nisur nga DVV dhe takimet online në Institucion, rekomandon futjen edhe të metodave të tjera të matjes së cilësisë, pyetësorë drejtuar stafit akademik, stafit administrativ, fokus grupet drejtuar studentëve, takimet peer - peer etj.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Asnjë përmbushje</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e	DITD harton në fund të çdo viti akademik, Raportin Vjetor të Departamentit [Evidencë I.7], në të cilin bëhet edhe vlerësimi i

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>mbarëvajtjes së programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale”.</p> <p>Nisur nga RVB dhe takimet <i>online</i> në Institucion, GVJ konstatoi se Institucioni përdor si metodë të matjes së cilësisë së veprimtarive akademike, vetëm pyetësorët drejtuar studentëve.</p> <p><i>GVJ rekomandon futjen edhe të metodave të tjera të matjes së cilësisë, pyetësorë drejtuar stafit akademik, stafit administrativ, fokus grupet drejtuar studentëve, takimet peer - peer etj.</i></p>			
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>				
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për</p>	<p>Në kuadër të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Navale”, Institucioni nxit dhe garanton plotësimin e standardeve të cilësisë dhe përfshirjen e gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të tij në politikat dhe procedurat që lidhen me to.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.				
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Nisur nga RVB dhe takimet <i>online</i> në Institucion, GVJ konstatoi se pavarësisht ngritjes së strukturave të sigurimit të cilësisë në nivel Institucioni dhe Fakulteti, ato nuk janë të plotësuara me staf. Kjo mangësi vihet re në metodat e kufizuara të matjes së cilësisë së veprimtarive akademike, vetëm përmes pyetësorëve drejtuar studentëve dhe një bashkëpunim të dobët dhe shpeshherë jo funksional midis Njësiave Kryesore/Njësiave Bazë dhe NJSBCVI.			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	<i>GVJ rekomandon Institucionin në plotësimin e komisioneve dhe strukturave të tjera të sigurimit të cilësisë në nivel Institucioni dhe Fakulteti me staf, për të mundësuar funksionimin më të mirë të tij.</i>			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.				
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucion është transparent me studentët dhe të gjithë të interesuarit lidhur me veprimtaritë në kuadër të SBC. Gjatë takimeve <i>online</i> në Institucion, GVJ konkludoi se studentët dhe stafi kishin informacion të konsiderueshëm lidhur me veprimtaritë e Institucionit në funksion të SBC.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional publikon në faqen e Universitetit <i>online</i> raportin përfundimtar të analizës së vlerësimit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e stafit akademik. Kjo

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	analizë ju përcillet zyrtarisht të gjitha njësive bazë, të cilat përcjellin vlerësimin individual tek secili pedagog.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	DITD diskuton raportin përmbledhës të formularëve të vlerësimit të mësimdhënies dhe performancës së stafit akademik të hartuar nga NJSBCVI, në mbledhjet e departamentit, duke evidentuar praktikat më të mira dhe duke hartuar plan masash për përmirësimin e pikave të dobëta. Rezultatet e pyetësorëve dhe analiza përkatëse në Departament bëhen pjesë e raportit vjetor të Departamentit [Evidencë I.7].			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni, nën monitorimin e NJSBCVI ndjek efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të përmirësimit në vijim të cilësisë së programit të studimit.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni organizon në mënyrë periodike veprimtari me qëllim ngritjen e kulturës së cilësisë, të tilla si seminare informuese me studentët dhe stafin akademik, publikime të informacioneve në rrjetet <i>online</i> , në sistemin e menaxhimit të informacionit etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Inxhinieri Navale” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit *Bachelor* në “Inxhinieri Navale” ofrohet në përputhje me prioritetet e zhvillimit kombëtar dhe rajonal duke synuar ruajtjen e traditës kombëtare në ndërtimin dhe shfrytëzimin e anijeve, konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të kësaj tradite, në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit të sektorit detar dhe në harmoni me kërkesat e Organizatës Ndërkombëtare të Detarisë (*International Marine Organization – IMO*).
2. DITD dhe FSHTN disponojnë laboratorë me infrastrukturë laboratorike bashkëkohore duke mundësuar një integrim shumë të mirë të mësimit teorik me atë praktik, për arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.
3. DITD është pjesë e një sërë projektet ndërkombëtare në fushën e inxhinierisë navale, duke mundësuar përditësimin e vazhdueshëm të stafit me të reja më të fundit të fushës dhe duke e rritur atë në drejtim të kërkimit shkencor.

Pika të dobta:



1. Mungesa e një studimi të mirëfilltë të tregut të punës.
2. Në disa lëndë janë angazhuar si lektorë pedagogë pa grada dhe tituj shkencorë
3. Të dhëna të kufizuara mbi punësimin e të diplomuarve.
4. Mungesa e veprimtarive laboratore dhe detyra kursi, në përputhje me profilin inxhinierik të ofruar. Raport i njëjtë orë/ECTS për veprimtaritë e ndryshme.
5. Vlerësimi përfundimtar ndryshon nga njëra lëndë në tjetrën. Në disa lëndë, në të cilat provimi përfundimtar është 55 pikë, studenti mund të rezultojë kalues edhe pa zhvillimin e provimit përfundimtar, me pikët e mbledhura gjatë vitit.
6. Mungesa e aktiviteteve trajnuese nga Institucioni, me qëllim përmirësimin e aftësive mësimdhënëse të stafit akademik dhe implementimin e metodave të reja në mësimdhënie.
7. Provimet zhvillohen pa sekretim apo kodim.
8. Pyetësorët e studentëve janë e vetmja formë e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies.



9. Mungesa e ambjenteve të përshtatshme për vendosjen e bazës laboratorike në dispozicion të DITD.
10. Strukturat e sigurimit të cilësisë të ngritura në nivel Institucioni dhe Fakulteti nuk janë të plotësuara me staf. Kjo mangësi vihet re në metodat e kufizuara të matjes së cilësisë së veprimtarive akademike, vetëm përmes pyetësorëve drejtuar studentëve dhe një bashkëpunim të dobët dhe shpeshherë jo funksional midis Njësive Kryesore/Njësive Bazë dhe NJSBCVI.

Rekomandime:

1. GVJ rekomandon zhvillimin periodik të studimit të tregut të punës në bashkëpunim me aktorët lokalë dhe ndërkombëtarë, duke përcaktuar qartë kërkesat dhe nevojat e tyre, si dhe mundësitë e punësimit të studentëve.
2. GVJ rekomandon institucionin të forcojë lidhjen me alumnit duke mundësuar gjurmimin e punësimit të tyre, të paktën për të diplomuarit në 3 vitet e fundit.
3. GVJ rekomandon rishikimin e kurrikulës duke rishpërndarë kreditet brenda lëndëve, duke përfshirë në kurrikul edhe veprimtaritë laborator dhe detyra kursi, si dhe duke rishikuar raportet orë/ECTS sipas llojit të veprimtarive.
4. GVJ rekomandon që vlerësimi i provimit përfundimtar të jetë të paktën 60% e vlerësimit total, duke u bërë kështu përcaktues për kalimin ose jo me sukses të lëndës nga ana e studentit (me pikëzimin aktual të disa lëndëve, studenti mund të rezultojë kalues edhe vetëm me pikët e mbledhura gjatë vitit).
5. GVJ rekomandon plotësimin e lektorëve për të gjitha lëndët me staf me grada dhe tituj shkencorë, duke angazhuar pedagogë me kontratë, ose duke nxitur stafin e angazhuar në marrjen e tyre.
6. GVJ rekomandon organizimin e aktiviteteve trajnuese nga vetë Institucioni, me qëllim përmirësimin e aftësive mësimdhënëse të stafit akademik dhe implementimin e metodave të reja në mësimdhënie.
7. GVJ rekomandon zhvillimin me sekretim ose kodifikim të provimeve duke ruajtur anonimitetin në korigjimin e tyre.



8. GVJ rekomandon futjen e metodave të tjera të matjes së cilësisë, pyetësorë drejtuar stafit akademik, stafit administrativ, fokus grupet drejtuar studentëve, takimet peer - peer etj.
9. GVJ rekomandon Institucionin të krijojë mundësinë e ambjenteve të përshtatshme për vendosjen e bazës laboratorike në dispozicion të DITD.
10. GVJ rekomandon Institucionin të plotësojë komisionet dhe strukturat e tjera të sigurimit të cilësisë në nivel Institucioni dhe Fakulteti me staf, për të mundësuar funksionimin më të mirë të tij.



Conclusions of the Evaluation of the study first cycle study program Bachelor in "Naval engineering" of the "Ismail Qemali" University

Strengths and affirmations:

1. The Bachelor study program in "Naval Engineering" is offered in accordance with national and regional development priorities aiming to preserve the national tradition in shipbuilding and operation, consolidation and further development of this tradition, in accordance with the national development strategy of the maritime sector and in accordance with the requirements of the International Marine Organization (IMO).
2. DITD and FSHTN have modern laboratory infrastructure, enabling a very good integration of theoretical and practical teaching, to achieve the formation objectives of the study program.
3. DITD is part of a series of international projects in the field of naval engineering, enabling continuous updating of staff with the latest news in the field and increasing it in terms of research.

Weak points:



1. Lack of a proper labor market study.
2. Lecturers of some subjects are pedagogues without a degree or scientific title.
3. Limited data on employment of graduates.
4. Lack of laboratory activities and course assignments, in accordance with the engineering profile offered. Same hour / ECTS report for different activities.
5. The final grade varies from one subject to another. In some subjects, in which the final exam is 55 points, the student may be successful even without the final exam, with the points collected during the year.



6. Lack of training activities by the Institution, in order to improve the teaching skills of the academic staff and the implementation of new teaching methods.
7. Exams are conducted without secretion or coding.
8. Student questionnaires are the only form of assessing the quality of teaching.
9. Lack of suitable facilities for placing the laboratory base available to DITD.
10. Quality assurance structures set up at the level of the Institution and the Faculty are not fully staffed. This shortcoming is noticed in the limited methods of measuring the quality of academic activities, only through questionnaires addressed to students and a weak and often non-functional cooperation between the Main Units / Basic Units and NJSBCVI.

Recommendations:

1. EEG recommends the periodic development of labor market research in cooperation with local and international actors, clearly defining their requirements and needs, as well as employment opportunities for students.
2. EEG recommends the institution to strengthen the connection with the ALUMNI by enabling the tracing of their employment, at least for the graduates of the last 3 years.
3. EEG recommends reviewing the curriculum by redistributing credits within the courses, including in the curriculum laboratory activities and course assignments, as well as reviewing the hourly / ECTS ratios by type of activities.
4. EEG recommends that the final exam grade be at least 60% of the total grade, thus determining whether or not the student successfully passes the course (with the current scoring of some courses, the student can pass only with points collected during the year).
5. EEG recommends filling all courses with staff with degrees and scientific titles, by hiring contracted professors, or by encouraging the staff engaged in further advancement in their academic profile.
6. EEG recommends the organization of training activities by the Institution itself, in order to improve the teaching skills of the academic staff and the implementation of new teaching methods.
7. EEG recommends conducting the secrecy or codification of exams while maintaining anonymity in their correction.
8. EEG recommends the introduction of other methods of quality measurement, questionnaires for academic staff, administrative staff, and focus groups for students, peer - peer meetings, etc.
9. EEG recommends the Institution to create the possibility to find suitable facilities for placing the laboratory base available to DITD.
10. EEG recommends the Institution to supplement the commissions and other quality assurance structures at the level of the Institution and the Faculty with staff, in order to enable its better functioning.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

Karavani

Georgina